



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

DREJTORIA TEKNIKE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Operatorit Ekonomik "IT Gjergji Kompjuter" sh.p.k

Adresa: Tirane Njesia Bashkiake nr.2, Rruga "Faik Konica", ndertesa nr.3, hyrja nr.7, Tirane, Shqiperi

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar** (marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues).

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Loti II** "Materiale Kancelarie të tjera zyre", me Nr. **REF-13601-07-18-2024** për nevoja të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër. Lëvrimi/dorëzimi i mallit për lotin e dytë do të bëhet brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës/kontratave brenda marrëveshjes kuader nga Autoritetet kontraktore përfituese.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 40 datë 22 Korrik 2024

Publikimet e mëparshme (njoftimi i fituesit paraprak): Buletini Nr. 70 datë 21 Tetor 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

- **Operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k** **NUIS J62426002Q**

Vlera e ofertës pa tvsh = 3,067,537.41 (*tre milionë e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë pikë dyzet e një*) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k,** **NUIS K81503063B**

Vlera e ofertës pa tvsh = 5,447,254 (*pesë milionë e katërqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër*) lekë pa TVSH..

- **Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k,** **NUIS L91418502J**

Vlera e ofertës pa tvsh = 4,777,777 (*katër milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë*) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k** **NUIS J72124001N**

Vlera e ofertës pa tvsh = 4,091,468 (*katër milionë e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë*) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k,** **NUIS L91418502J**

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k. me dokumentacionin e paraqitur nuk përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, për arsyet konkretisht si më poshtë:

- Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e pikës 3.2 të **Seksionit 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike** së DST ku përcaktohet se: *Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 250 (dyqind e pesëdhjetë) ditë.*

Operatori ekonomik, ka paraqitur sigurimin e ofertës me periudhë vlefshmërie 150 (*njëqind e pesëdhjetë*) ditë duke mos e plotësuar këtë kriter. OE skualifikohet pasi nuk përmbush të gjitha kushtet dhe kërkesat për kualifikim

- **Operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k** **NUIS J62426002Q**

Për arsyet e mëposhtme:

Adresa: Rruga: “Reshit Çollaku”, Godina nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) www.obp.al, info@obp.al

Në zbatim të pikës 4, të nenit 82, të kreut X, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar Komisioni verifikoi sipas formulës së përcaktuar në dokumentet e tenderit, në qoftë se ofertat e vlefshme/kualifikuara janë anomalisht të ulëta, konkretisht kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Mo = 4,202,086.47 lekë

Zm = 85% Mo = 3,571,773.5 lekë pa TVSH.

Nga përlllogaritja rezultoi se oferta ekonomike me vlerë 3,067,537.41 (tre milionë e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë pikë dyzet e një) lekë pa TVSH, paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k me NUIS J62426002Q, është anomalisht e ulët.

Në këto kushte, referuar në parashikimet e nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 të ndryshuar, cituar:

1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për: a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës; 60 d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

KVO më datë 30.09.2024 nëpërmjet SPE ju drejtua OE “InfoSoft Office” sh.p.k. duke i kërkuar të paraqiste argumentim në përputhje me parashikimet e sipërcituara të LPP.

Deri sot më datë 09.10.2024 OE “InfoSoft Office” sh.p.k. nuk ka paraqitur asnjë argumentim mbi ofertën anomalisht të ulët, as në SPE dhe as në rrugë shkresore. Në këto kushte operatori ekonomik s’kualifikohet për mos argumentim të ofertës ekonomike anomalisht të ulët.

“InfoSoft Office” SH.P.K. – s’kualifikohet

-Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat e Nenit 93 të ligjit nr.162/2020 pasi në vijim të kërkesës së dërguar nga KVO mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 93 pika 2 të ligjit nr.162/2020, të ndryshuar KVO në mënyrë përfundimtare vlerëson se **operatori ekonomik nuk e ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët dhe vendos të mos e pranojë ofertën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k me NUIS J62426002Q.**

- **Operatori ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k NUIS J72124001N**
(sipas vendimit të KPP Nr 1656/2024).

Për arsyet e mëposhtme:

Në bazë të Vendimit të KPP nr. 1656/2024 dt. 21.11.2024, i detytueshëm për zbatim dhe Vendimit të KSHA-së, konstatohet se: faturat e paraqitura si dëshmi për eksperiencën e meparshme, konsistojnë në tre fatura nga te cilat dy fatura datojnë pas shpalljes së kontratës. Konkretisht, Autoriteti Kontraktor ka publikuar procedurën e prokurimit me objekt: "Loti II "Materiale Kancelarie te tjera zyre" në datë 19.07.2024 dhe data e zhvillimit te procedures është 10.09.2024. Dy nga faturat e paraqitura nga operatori ekonomik "MARKETING & DISTRIBUTION" shpk mbajnë datën 12.08.2024, pra pas datës shpalljes së njoftimit të kontratis. Ndërsa fatura e cila dëshmon se është realizuar furnizimi përkatës brenda afatit kohor ti parashikuar në kite kriter nuk arrin te plotësojë vlerën e kërkuar. Në kete kuptim, kerkesa lidhur me dëshminë e eskperiencave të mëparshme rezulton e papërbushur nga ana e operatorit ekonomik "MARKETING & DISTRIBUTION" shpk, konkretisht per dy komponentë, kryerja e tyre gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit te kontratës si dhe vlera jo më te vogël se 20 % e vlerës së fondit limit

Duke iu referuar procedurës së mësipërme meqënëse procedura është marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, **ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues** ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm i identifikuar si i suksesshëm është:

- **Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k,** **NUIS K81503063B**

Vlera e ofertës pa tvsh = 5,447,254 (pesë milionë e katërqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH..

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Operatori i Blerejeve të Përqëndruara sha brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen kuadër.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. Datë): Referuar vendimit përfundimtar të KPP -së nr 1656/2024.

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO

JO